



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1149/9 prot.

Tiranë, më 03.07.2026

V E N D I M

Nr. 23, datë 03.07.2026

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 4, 5, 6 dhe 7, pikës 1 dhe shkronjave “c”, “dh”, “e” dhe “f” të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) në përmbushje të Programit të Punës për vitin 2026 (<https://idp.al/wp-content/uploads/2026/02/Plani-i-Punes-2026.pdf>), si dhe në zbatim të Planit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive për vitin 2026 (<https://idp.al/wp-content/uploads/2026/03/PLANI-I-MONITORIMIT-DHE-MBIKEQYRJES-SE-TRANSPARENCES-PROAKTIVE-PER-VITIN-2026-1.pdf>), ka kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës së autoritetit publik “Bashkia Krujë” (në vijim “Autoriteti publik”).

Autoriteti publik i ushtron kompetencat e tij bazuar në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Në pikën 1 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) përcaktohet se: “*“Autoritet publik”:* a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, **organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli**, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”. Për rrjedhojë, Bashkia Krujë konsiderohet autoritet publik në kuptim të LDI-së.

Në pikën 1 të nenit 4 të LDI-së parashikohet se: “Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”. Në pikën 3 të nenit 4 të LDI-së përcaktohet se: “Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”. Ndërsa, në nenin 6 të LDI-së parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike...”

Neni 8 i LDI-së përcakton se: “1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. 2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”.

Bazuar në nenin 6 të LDI-së, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ka nxjerrë Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore” (në vijim “Urdhri nr. 281/2025”). Urdhri nr. 281/2025 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë 08.01.2026.

Bazuar në nenin 8 të LDI-së, Komisioneri ka nxjerrë Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara” (në vijim “Urdhri nr. 188/2020”). Urdhri nr. 188/2020 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224, datë 22.12.2020.

Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në Planin e Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike për vitin 2026, miratuar me shkresën nr. 630 prot., datë 27.02.2026, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë autoritetit publik Urdhrin nr. 89, datë 23.04.2026 “Për kryerjen e hetimit administrativ”, me objekt:

- Përmbushja e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të autoritetit publik, kategoritë e informacionit, që bëhet publik pa kërkesë, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
- Përmbushja e detyrimit për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Më datë 13.05.2026, grupi i punës i Zyrës së Komisionerit u paraqit pranë autoritetit publik, i cili është njoftuar edhe nëpërmjet komunikimit elektronik në datën 08.05.2026 për zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ. Gjatë procesit të hetimit administrativ nuk u paraqit titullari i autoritetit publik (në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës) dhe koordinatori për të drejtën e informimit (në cilësinë

e personit përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve). Grupit të punës së Zyrës së Komisionerit nuk iu paraqit asnjë argument dhe/ose provë shkresore për sa më sipër, ndërsa në mënyrë verbale iu komunikua se titullari kishte angazhime të tjera institucionale.

Autoriteti publik, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 15.05.2026, bashkëlidhur në format *pdf* shkresa nr. 3700 prot., datë 15.05.2026 (administruar me tonën me nr. 1149/3 prot., datë 18.05.2026), ka kërkuar mundësinë për rihvillimin e hetimit administrativ.

Zyra e Komisionerit monitoroi *online* faqen zyrtare të Bashkisë Krujë <https://kruja.gov.al/>, më datë 20.05.2026, dhe konstatoi se autoriteti publik nuk ka vendosur në zbatim Programin Institucional të Transparencës sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 të Komisionerit, si dhe nuk ka publikuar të gjitha kategoritë/nënkategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, bazuar në nenin 7 të LDI-së.

Në këto kushte, me qëllim ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar të personit përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, me shkresën nr. 1149/4 prot., datë 21.05.2026, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore, e parashikuar për t'u mbajtur në datën 29.05.2026. Vlerësimi për zhvillimin e një seance dëgjimore buron nga e drejta për të paraqitur qëndrimet, argumentet dhe/ose provat, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, si dhe nenin 87 të këtij Kodi, i cili parashikon të drejtën e palës për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar.

Në ditën dhe orën e caktuar në seancën dëgjimore u paraqitën 3 përfaqësues të autoritetit publik, znj. Yllka Kukalaj, zëvendëskryetar i Bashkisë Krujë, z. Florind Cerhozi, Sekretar i Përgjithshëm dhe z. Xhulian Kafexhiu, specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, sipas autorizimit nr. 4007 prot., datë 25.05.2026, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, z. Artur Bushi. Gjatë kësaj seance, Zyrës së Komisionerit iu vendos në dispozicion dhe u njoh me kopjen e Vendimit nr. 214, datë 15.05.2026 "Për delegimin e kompetencave". Gjithashtu, Zyrës së Komisionerit iu vendos në dispozicion dhe u njoh me Urdhrin nr. 215, datë 15.05.2026 "Për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit" të Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit rimonitoroi faqen zyrtare të autoritetit publik, gjatë së cilës u konstatua se Programi i Transparencës së Bashkisë Krujë nuk ishte i publikuar sipas formatit të Urdhrit nr. 281/2025 dhe se kishte mungesa të informacionit/dokumentacionit për çdo kategori/nënkategori të tij. Ky fakt u pranua edhe nga përfaqësuesit e autoritetit publik, të cilët deklaruan se kjo situatë ka ardhur si pasojë e problematikave me administrimin/mirëmbajtjen e faqes zyrtare, burimeve njerëzore të kufizuara, situatës së krijuar në territorin e kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore pas

tërmetit të datës 26.11.2019, por edhe menaxhimit të pasojave të tij për një periudhë të gjatë kohe. Autoritetit publik iu la afat deri më datë 15.06.2026 për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me Programin e Transparencës.

Sipas Urdhrit nr. 281/2025, autoritetet publike (njësitë e vetëqeverisjes vendore) kishin afat deri në datën 31.03.2026 për të bërë ndryshimet e Programit Institucional të Transparencës, fakt i cili i është bërë me dije Bashkisë Krujë edhe nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 09.01.2026.

Zyra e Komisionerit konstatoi se deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi rezulton se autoriteti publik vijon të mos ketë publikuar në faqen zyrtare informacionin/dokumentacionin në kategoritë/nënkategoritë e Programit të Transparencës së Bashkisë Krujë në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe formatin e Urdhrit nr. 281/2025.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë.

Nga ana tjetër, Programi i Transparencës përfaqëson një nga instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, për rrjedhojë çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht për vënien në zbatim dhe përditësimin me informacion të tij.

Në përputhje me Programin e Transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këta të fundit përgatisin në formate lehtësisht të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të LDI-së.

Pika 1 e nenit 18 të LDI-së parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*. Shkronja “ç”/1) e pikës 2 të nenit 18 të LDI-së parashikon se: *“Mospublikimi i akteve brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 7 dhe mospërditësimi i kategorive të informacionit të programit institucional të transparencës sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë”*.

Pika 1 e nenit 19 të LDI-së parashikon se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në shkronjën “ç”/1) të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Pika 2 e nenit 19 të LDI-së parashikon se: *“Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, titullari i autoritetit publik mund të delegojë kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1 të nenit 4, pikat 1 dhe 2 të nenit 5, pikën 4 të nenit 7, pikat 1 dhe 2 të nenit 13 të këtij ligji, te nëpunësi më i lartë i autoritetit publik. Në këtë rast, nëpunësi të cilit i është deleguar*

kompetenca, mban përgjegjësi për shkeljet administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni”.

Referuar këtij parashikimi ligjor, përgjegjësia për vënien në zbatim dhe publikimin/përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës rezulton se është e znj. Yllka Kukalaj, zëvendëskryetar pranë Bashkisë Krujë.

Në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 10 të LDI-së parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji”.*

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan gjatë procesit të hetimit administrativ, por edhe nga monitorimi dhe rimonitorimi i faqes zyrtare të internetit të autoritetit publik, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për vënien në zbatim të Programit Institucional të Transparencës, sipas Urdhrit nr. 281/2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “ç”/1) të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së.

Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, faktin që personi përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen e detyrimeve ligjore të sipërpërmendura dhe, gjithashtu, bazuar në parimin e proporcionalitetit, dënimi me masë administrative (gjobë) vlerësohet të jetë në kufirin minimal.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 9/1, shkronjat “ç”/1 dhe “d” të pikës 2 të nenit 18, pikat 1 dhe 2 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21 dhe nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Autoriteti publik “Bashkia Krujë”, në zbatim të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, të vërë në zbatim, publikojë, pasqyrojë, përditësojë dhe ndërlidhë në Programin Institucional të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe duke pasur në konsideratë kufizimet e nenit 17 të tij, si dhe formatit të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 20.07.2026.
2. Dënimin e znj. Yllka Kukalaj, zëvendëskryetar i Bashkisë Krujë, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

3. Koordinator për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik “Bashkia Krujë”, të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve bazuar në pikën 1 të nenit 8 të ligjit “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara”, brenda datës 20.07.2026.
4. Masa e dënimit me gjobë shlyhet me këste mujore. Gjopa ekzekutohen nga zyra e financës së autoritetit publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 3, autoriteti publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
6. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ky vendim u shpall sot, më datë 03.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi